



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

Adresa: Rr “Reshit Collaku” Nr. 6 / Pranë ILDKP, Tiranë
Tel: 042 220 499 Site: www.kkk.gov.al E_mail: info@kkk.gov.al

UDHËZUES

PËR

PËRGATITJEN E RAPORTIT JOFINANCIAR
(metodologjia për raportimin e informacionit jofinanciar)

(Në zbatim të nenit 18 të Ligjit 25, datë 10.05.2018
“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”)

Ky dokument transponon Komunikatën¹ e Komisionit Europian “Udhëzues për raportimin jo-financiar”

¹ COMMUNICATION FROM THE EUROPEAN COMMISSION Guidelines on non-financial reporting (methodology for reporting non-financial information) (2017/C 215/01)

Tabela e përmbajtjes

	<i>Faqe</i>
1. Hyrje	
2. Qëllimi	
3. Parimet kryesore	
3.1. <i>Paraqitet informacion material</i>	
3.2. <i>Paraqitet informacion i drejtë, i balancuar dhe i kuptueshëm</i>	
3.3. <i>Paraqitet informacion gjithëpërfshirës por konciz</i>	
3.4. <i>Paraqitet informacion strategjik dhe largpamës</i>	
3.5. <i>Paraqitet informacion i orientuar nga palët e interesit</i>	
3.6. <i>Paraqitet informacion i qëndrueshëm dhe koherent</i>	
4. Përmbajtja	
4.1. <i>Modeli i biznesit</i>	
4.2. <i>Politikat due diligence</i>	
4.3. <i>Rezultati</i>	
4.4. <i>Rreziqet kryesore dhe menaxhimi i tyre</i>	
4.5. <i>Treguesit kryesorë të performancës</i>	
4.6. <i>Aspektet tematike</i>	
5. Informacione për diversitetin e Këshillit Drejtues	

1. HYRJJE

Ligji 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, hyri në fuqi në 1 janar 2019. Ligji i ri i kontabilitetit përaftron Direktivën e Kontabilitetit 2013/34/BE kryesisht në çështjet e klasifikimit të njësive ekonomike dhe grupeve si dhe në kërkesat për përgatitjen e raportit të ecurisë së veprimtarisë, raportit jofinanciar dhe raportit të drejtimit të brendshëm. Gjithashtu ligji i ri ka përmirësuar dhe disa kërkesa lidhur me publikimin e raporteve financiare dhe jofinanciare.

Një transparencë më e madhe pritet t'i bëjë njësitë më elastike dhe të performojnë më mirë, në aspektin financiar dhe jo-financiar. Me kalimin e kohës kjo do të çojë në një rritje të biznesit dhe punësimit si dhe rritje të besimit midis palëve të interesuara, përfshirë investitorët dhe konsumatorët. Menaxhimi transparent i biznesit është gjithashtu në përputhje me synimin për investime më afatgjata.

Kërkesat e dhënies së shënimeve shpjeguese për informacion jo-financiar zbatohen për disa njësi të mëdha me më shumë se 500 të punësuar, pasi kostoja e detyrimit të njësive të vogla dhe të mesme për t'i zbatuar ato mund të tejkalojë përfitimet.

Njësive u kërkohet të japin informacione të rëndësishme e të dobishme, të nevojshme për të kuptuar zhvillimin e tyre, performancën, pozicionin dhe ndikimin e veprimtarisë së tyre dhe jo një raport shterues e të hollësishëm. Për më tepër, shënimet shpjeguese mund të ofrohen në nivel grupi dhe jo nga secila njësi ekonomike, filial brenda një grupi. Direktiva gjithashtu u jep njësive fleksibilitet të konsiderueshëm për ta dhënë informacionin përkatës, në mënyrën që ata e konsiderojnë më të dobishëm, të përfshirë në një raport të veçantë.

Udhëzime jo detyruese

Neni 18 i Ligjit 25/2018 i referohet detyrimit që kanë njësitë e mëdha, të cilat janë me interes publik dhe që tejkalojnë kriterin e numrit mesatar prej 500 të punësuarish gjatë periudhës raportuese, për të përfshirë në raportin e ecurisë së veprimtarisë një raport jo-financiar, i cili përmban informacionin e nevojshëm për një kuptim më të mirë të zhvillimit të vetë njësisë ekonomike, performancës, pozicionit dhe ndikimit të saj lidhur me mjedisin, çështjet sociale dhe ato të punësimit, respektimin e të drejtave të njeriut, antikorrupsionin dhe çështje të ryshfetit. Në këtë nen janë dhënë çështjet kryesore që duhet të përmbajë raporti jo-financiar ndërsa ky udhëzues jep sqarime të mëtejshme se çfarë duhet përfshirë në secilin prej krerëve të raportit jo-financiar duke përfshirë treguesit kryesorë të performancës (TKP-të) jo-financiare, të përgjithshëm dhe sektorialë, me qëllim mundësimin e shpjegimeve të rëndësishme, të përdorshme dhe të krahasueshme të përgatitura nga njësitë ekonomike. [...].’

Ky Udhëzues transponon Komunikatën e Komisionit Europian “Udhëzues për raportimin jo-financiar”, dokument i cili ka marrë parasysh praktikat aktuale më të mira, zhvillimet ndërkombëtare dhe rezultatet e nismave të tjera të lidhura me to, brenda Unionit.

Pavarësisht këtij Udhëzuesi të KKK-së, njësitë mund të zgjedhin të përdorin një kuadër raportimi gjerësisht të pranuar dhe me cilësi të lartë, pjesërisht ose në përputhje të plotë me të. Njësitë mund të mbështeten në një kuadër raportimi ndërkombëtar, të Bashkimit Evropian ose kombëtar dhe nëse është kështu, specifikojnë kuadrin që ato përdorin.

KKK inkurajon njësitë të përfitojnë nga fleksibiliteti i kërkesave të parashikuara në nenin 18 të ligjit të kontabilitetit, kur të shpjegojnë informacionet jo-financiare. Udhëzimet në këtë dokument nuk kanë për qëllim të pengojnë risitë në praktikat e raportimit.

Kuadrot e ndryshme të raportimit - kombëtare, të Bashkimit Evropian apo ndërkombëtare

Në përgatitjen e këtij Udhëzimi, KKK i është referuar Komunikatës së KE “Udhëzuesi për raportimin jo-financiar”. Parimet dhe përmbajtja e përshkruar në Komunikatën e KE “Udhëzuesi për raportimin jo-financiar” mbështetet kryesisht në kuadro të tilla si:

- CDP – Projekti i mëparshëm për shënime shpjeguese mbi Karbonin;
- Bordi i Standardeve të Raportimit për Klimën;
- Udhëzimi për Due Diligence i OECD-së për Zinxhirët e Përgjegjshëm të Furnizimit nga zonat e ndikuara nga konflikti dhe ato me rrezik të lartë, dhe shtesat e tij;
- Skema e Eko Menaxhimit dhe Auditimit (EMAS) dhe Dokumentet e Referencës Sektoriale;
- Federata Evropiane e Shoqatave të Analistëve Financiarë të Treguesve Kryesorë të Përformancës Mjedisore, Sociale dhe Qeverisë, një Udhëzues për Integrimin e TKP-ve mjedisor, social dhe të qeverisjes në Analizën Financiare dhe Vlerësimin e Korporatave;
- Iniciativa Globale e Raportimit;
- Udhëzuesi për Zinxhirin e Përgjegjshëm të Furnizimit në Bujqësi të FAO-OECD;
- Udhëzuesi mbi Raportin Strategjik të Këshillit të Raportimit Financiar (Britani e Madhe);
- Udhëzimet për Kompanitë Shumëkombëshe të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD)
- Parimet Udhëzuese të Kuadrit Raportues për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut;
- ISO 26000 e Organizatës Ndërkombëtare të Standardizimit;
- Kuadri Ndërkombëtar i Raportimit të Integruar;
- Model Udhëzimi mbi Raportimin e informacionit mjedisor, social dhe qeverisë për investitorët e Iniciativës për Bursat e Qëndrueshme (Kombet e Bashkuara);
- Protokollin e Kapitalit Natyror;
- Udhëzimi për ndikimin në Mjedis të Prodhimit dhe Organizmit;
- Bordi i Standardeve të Kontabilitetit të Qëndrueshëm;
- Kodet e qëndrueshmërisë i Këshillit Gjerman për Zhvillimin e Qëndrueshëm;
- Deklarata Trepalëshe e Parimeve lidhur me Kompanitë Shumëkombëshe dhe politikat sociale të Organizatës Ndërkombëtare të Punës;
- Impakti Global (Kombet e Bashkuara);
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Kombet e Bashkuara), Resoluta e 25 Shtatorit 2015 Transformimi i botës sonë: Axhenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm;
- Parimet Udhëzuese (Kombet e Bashkuara) mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut që implementon kuadrin “Mbro, Respekto dhe Ndreq” të Kombeve të Bashkuara;

E rëndësishme

Ky dokument është përgatitur në pajtim me nenin 18 të Ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” në mënyrë që të ndihmojë njësitë e interesuara të paraqesin informacionin jo-financiar në një mënyrë të rëndësishme, të dobishme, të qëndrueshme dhe më të krahasueshme. Kjo dokument përban udhëzime jo detyruese dhe nuk krijon detyrime të reja ligjore.

Njësitë që përdorin këtë Udhëzues mund të mbështeten gjithashtu në një kuadrin tjetër ndërkombëtar, të BE ose kombëtar. Ky dokument nuk përbën një standard teknik dhe as përgatitësit e raportit jo-financiar, as ndonjë palë tjetër, qoftë duke vepruar në emër të një përgatitësi apo ndryshe, nuk duhet të pretendojnë se raporti jo-financiar është në përputhje me këtë dokument.

2. QËLLIMI

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të ndihmojë njësitë të paraqesin një informacion jo-financiar (për çështjet mjedisore, sociale dhe të drejtimit) me cilësi të lartë, të rëndësishëm, të dobishëm, të qëndrueshëm dhe më të krahasueshëm, në mënyrë të tillë që të nxisë rritjen e shpejtë dhe të qëndrueshme, punësimin dhe transparencën për palët e interesuara. Ky udhëzues jo detyrues propozohet në kuadër të kërkesave të raportimit të parashikuara në Ligjin e kontabilitetit. Udhëzuesi ka për qëllim të ndihmojë njësitë të hartojnë një raport jo-financiar të rëndësishëm, konciz, të dobishëm dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit.

Në hartimin e Udhëzuesit, janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të shmangur barrën e padrejtë administrative, shpjegime të tepërta apo të një ushtrimi të varfër të tipit ‘tick the box’.

Ky udhëzues jo-detyrues vendos theksin në informacionin e rëndësishëm, të dobishëm dhe të krahasueshëm jo-financiar, në përputhje me nenin 18 të ligjit të kontabilitetit për dhënien e informacionit jofinanciar dhe diversitetit nga njësitë e mëdha, me interes publik që tejkalojnë kriterin e numrit mesatar të 500 të punësuarve gjatë periudhës raportuese.

Ky udhëzues u drejtohet njësive, subjekt i kërkesës së Ligjit të kontabilitetit, për të dhënë informacion jo-financiar në raportin e tyre të ecurisë së veprimtarisë. Sidoqoftë, ky udhëzues jo-detyrues mund të përfaqësojë praktikën më të mirë për të gjitha njësitë që japin informacion jo-financiar, përfshirë dhe njësitë e tjera që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të Ligjit të kontabilitetit.

Ky udhëzues është përshtatur në kontekstin e raportit të ecurisë së veprimtarisë. Sipas nenit 18 të Ligjit të kontabilitetit, raporti i ecurisë së veprimtarisë përfshin raportin jo-financiar.

Synimi i përgatitjes së këtij dokumenti është të sigurohet një udhëzues i ekuilibruar dhe fleksibël për raportimin e informacionit jofinanciar në mënyrë të tillë që ndihmon njësitë të paraqesin informacionin material në mënyrë të qëndrueshme dhe koherente. Ky udhëzues duhet

të ndihmojë, sa më shumë të jetë e mundur, në sigurimin e krahasueshmërisë midis njësive ekonomike dhe sektorëve.

Kjo qasje njih diversitetin e gjerë të bizneseve dhe sektorëve të përfshirë si dhe rrethanave që njësitet duhet të reflektojnë në raportimin e tyre. Janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të shmangur një qasje të tipit ‘*një madhësi që i përshtatet të gjithave*’ si edhe një metodologji ‘*tepër përshkruese*’.

Udhëzuesi njih rëndësinë e lidhjeve dhe ndërmarrëdhënieve midis informacionit (lidhjen), pavarësisht nëse ato janë ndërmjet aspekteve të ndryshme të informacionit jo-financiar ose midis informacionit financiar dhe jo-financiar.

3. PARIMET KRYESORE

3.1 Paraqitet informacioni material

Neni 18 i Ligjit të kontabilitetit përcakton që njësitet në fjalë:

[...] Do të përfshijnë në raportin e ecuresë së veprimtarisë një raport jo-financiar që përmban informacion në masën e nevojshme për të kuptuar zhvillimin, performancën, pozicionin dhe ndikimin e veprimtarisë së njësies [...]

Materialiteti është një koncept që përdoret zakonisht nga përgatitësit, audituesit dhe përdoruesit e informacionit financiar. Të kuptuarit e plotë të një njësie, për përbërësit kryesorë të zinxhirit të saj të vlerës, ndihmon në identifikimin e çështjeve kryesore dhe vlerësimin e asaj që e bën informacionin të quhet material.

SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*, paragrafi 7 dhe SKK 1 Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, paragrafi 70, e përcakton informacionin material si "*statusin e informacionit ku mungesa, paraqitja e gabuar ose e paqartë, ka pritshmëri të arsyeshme që të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme mund të marrin në bazë të atyre pasqyrave financiare, të cilat japin informacion financiar rreth një njësie ekonomike të caktuar*". Materialiteti i zërave individuale vlerësohet në kontekstin e zërave të tjerë të ngjashëm.

Ligji prezanton një element të ri që duhet të merret parasysh kur vlerësohet materialiteti i informacionit jo-financiar duke i'u referuar informacionit ‘*në masën e nevojshme për të kuptuar ndikimin [...] të aktivitetit (të njësies)*’².

Kur jepen informacione jo-financiare, është e rëndësishme të mbahet në konsideratë ndikimi i veprimtarisë së një njësie. Ndikimet mund të jenë pozitive ose negative. Dhënia e informacioneve shpjeguese materiale duhet t'i përfshijë të dyja llojet e ndikimeve, në mënyrë të qartë dhe të ekuilibruar. Raporti jo-financiar pritet të pasqyrojë një pamje të drejtë të informacionit të një njësie, për aq sa i'u nevojitet palëve të interesuara përkatëse.

² Neni 18 i Ligjit 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

Informacioni material duhet të vlerësohet në një kontekst të caktuar. Informacioni që mund të jetë material në një kontekst të caktuar mund të mos jetë i tillë në një tjetër. Çështjet që konsiderohen të përfshihen në raportin jo-financiar janë specifike për rrethanat e njësisë, duke marrë parasysh situata konkrete dhe konsiderata sektoriale. Njësitë brenda një industrie ka të ngjarë të ndajnë sfida të ngjashme mjedisore, sociale dhe qeverisëse, për shembull për shkak të burimeve në të cilat mbështeten për të prodhuar mallra dhe shërbime, ose efektet që mund të kenë ata te njerëzit, shoqëria dhe mjedisi. Prandaj mund të jetë e përshtatshme të krahasohen drejtpërdrejt informacionet jo-financiare përkatëse midis njësive në të njëjtin sektor.

Njësitë mund të raportojnë për një gamë të gjerë çështjesh potenciale. Një njësi vlerëson se cili informacion është material bazuar në analizën e tij dhe se sa i rëndësishëm është ai informacion për të kuptuar zhvillimin, performancën, pozicionin dhe ndikimin e njësisë. Ky vlerësim i materialitetit duhet të marrë parasysh faktorët e brendshëm dhe të jashtëm.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një bankë mund të konsiderojë se konsumi i ujit në zyrat qendrore dhe në degë nuk është çështje materiale për t'u përfshirë në raportin e saj të ecurisë së veprimtarisë. Por, banka mund të vlerësojë që ndikimet shoqërore dhe mjedisore të projekteve që ajo financon dhe roli i saj në mbështetjen e ekonomisë reale të një qyteti, një rajoni ose një vendi, janë informacion material.

Mund të merren parasysh disa faktorë kur vlerësohet materialiteti i informacionit, përfshirë këtu:

- *Modelin e biznesit, strategjinë dhe rreziqet kryesore:* qëllimet, strategjitë e një njësie, qasja e drejtimit dhe sistemet, vlerat, aktivet materiale dhe jo-materiale, zinxhiri i vlerës dhe rreziqet kryesore, të gjitha janë konsiderata të rëndësishme.
- *Çështjet kryesore sektoriale:* çështje të ngjashme ka të ngjarë të jenë materiale për njësitë që operojnë në të njëjtin sektor, ose që ndajnë zinxhirët e furnizimit. Çështjet e identifikuar tashmë nga konkurrentët, klientët ose furnitorët ka të ngjarë të jenë relevante për një njësi.
- *Interesat dhe pritshmëritë e palëve të interesuara përkatëse:* njësitë pritet të angazhohen me palët përkatëse të interesit dhe të kërkojnë të kuptojnë më mirë interesat dhe shqetësimet e tyre.
- *Ndikimi i aktiviteteve:* Njësitë pritet të marrin në konsideratë ashpërsinë aktuale dhe potenciale të ndikimeve të aktivitetit të saj. Kjo përfshin ndikimet e produkteve, shërbimeve dhe marrëdhënieve të biznesit (përfshirë aspektet e zinxhirit të furnizimit).
- *Politikat publike dhe nxitësit rregullatorë:* Politikat dhe rregulloret publike mund të kenë efekt në rrethanat specifike të një njësie dhe mund të ndikojnë materialitetin e informacionit.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të konsiderojë që ndikimi/et, përmes zinxhirit të saj të furnizimit, janë çështje relevante dhe materiale dhe raporton për to në përputhje me rrethanat. Ndikimet mund të jenë të drejtpërdrejta ose indirekte. Për shembull, një njësi që prodhon ujë mineral mund të konsiderojë si masa specifike të marra ato për të mbrojtur burimet hidrike në të cilat mbështetet.

Njësitë mund të shpjegojnë marrëveshjet e tyre të qeverisjes së brendshme dhe proceset e përdorura për të kryer vlerësimin e materialitetit të tyre.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi që ka ndikim në përdorimin e tokës dhe ndryshimin e ekosistemit (për shembull shpyllëzimi), drejtpërdrejt ose përmes zinxhirit të saj të furnizimit, mund të marrë në konsideratë të tregojë me shënimet e duhura si e ka zbatuar procesin *due diligence*.

Vlerësimet e materialitetit pritet të rishikohen në intervale të rregullta për të siguruar që çështjet e raportuara vazhdojnë, apo jo, të jenë materiale. Vlerësimet duhet të jenë më të shpeshta në njësitë dhe sektorët më dinamikë dhe inovatorë, ose në njësitë që ndryshojnë dhe përmirësojnë modelet ose politikat e tyre të biznesit, përfshirë këtu edhe procesin *due diligence*. Sidoqoftë, ato mund të jenë më pak të shpeshta në rrethana më të qëndrueshme.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi, e cila është e përfshirë në zinxhirët e furnizimit të mineraleve nga zonat e prekura nga konflikti dhe me rrezik të lartë, mund të marrë në konsideratë shënimet e duhura shpjeguese për procesin *due diligence* të aplikuar për të garantuar që i respekton të drejtat e njeriut dhe nuk kontribuon në konflikt.

3.2 Paraqitet informacioni i vërtetë, i balancuar dhe i kuptueshëm

Raporti jo-financiar duhet të bëjë një paraqitje të drejtë të aspekteve të favorshme dhe atyre të pafavorshme si dhe informacioni duhet të vlerësohet dhe paraqitet në një mënyrë të paanshme.

Raporti jo-financiar duhet të marrë parasysh të gjitha inputet e mundshme dhe të besueshme, duke marrë parasysh nevojat për informacion të palëve të interesuara përkatëse. Përdoruesit e informacionit nuk duhet të mashtrohen nga keqkuptimet materiale, pra njësi nuk mund të lërë mënjanë informacionet materiale duke dhënë me tepri informacione jomateriale.

Raporti jo-financiar duhet të dallojë qartë faktet nga pikëpamjet, opinionet ose interpretimet.

Informacioni mund të bëhet më i drejtë dhe më i saktë përmes, për shembull:

- marrëveshjeve të përshtatshme të qeverisjes së brendshme (për shembull, disa anëtarë të pavarur të Këshillit Drejtues ose një komitet i tij të cilit i është besuar përgjegjësia për çështjet e qëndrueshmërisë dhe / ose transparencës);
- provave të forta dhe të besueshme, sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe raportimit;
- angazhimit efektiv të palëve të interesit; dhe
- shërbimeve të sigurisë, të pavarura, ofruar nga palë jashtë njësisë.

Informacioni gjithashtu mund të bëhet më i kuptueshëm duke përdorur gjuhë të thjeshtë dhe terminologji të qëndrueshme, duke shmangur modelin e fjalëve standarde të përsëritshme dhe kur është e nevojshme, duke dhënë përkufizime për termat teknikë.

Informacioni material duhet dhënë në kontekstin e duhur për ta bërë më të lehtë të kuptuarit. Për shembull, performanca e një njësie mund, për shembull të paraqitet duke i'u referuar

strategjive të saj dhe qëllimeve më të gjera. Njësitë pritet të përshkruajnë se si çështjet jo-financiare lidhen me strategjinë e tyre afatgjatë, rreziqet kryesore dhe politikat.

Një njësi duhet të shpjegojë shtrirjen dhe kufijtë e informacionit të paraqitur, veçanërisht kur disa informacione lidhen vetëm me një ose disa segmente të tij, ose përjashton segmente specifike.

Kuptueshmëria gjithashtu mund të përmirësohet duke shpjeguar çështje të brendshme lidhur me informacionin jofinanciar, të tilla si metodat e matjes, supozimet themelore dhe burimet.

Raporti jo-financiar nuk ka të bëjë vetëm me sigurimin e një liste të treguesve kryesorë të performancës (TKP-të). Për të kuptuar si duhet zhvillimin, performancën, pozicionin dhe ndikimin e një njësie, duhet të paraqiten informacione cilësore dhe sasore. Ndërsa informacioni sasior mund të jetë efektiv në raportimin e disa çështjeve jo-financiare (treguesit e performancës, objektiva, etj.), informacioni cilësor siguron kontekstin dhe e bën raportin jo-financiar më të dobishëm dhe më të lehtë për t'u kuptuar. Një kombinim i raportimit narrativ, informacionit sasior dhe elementeve të paraqitjes vizuale, e bën komunikimin më efektiv dhe transparent.

Paraqitja e informacionit në një gjuhë të zakonshme biznesi, përveç gjuhës zyrtare të një njësie, ka të ngjarë të përmirësojë transparencën dhe të ndihmojë që informacionet të jenë më të kuptueshme për investitorët përkatës dhe palët e tjera të interesuara.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi që paraqet treguesit kryesorë të performancës (TKP-të) mund të rrisë transparencën duke siguruar informacion mbi qëllimin dhe lidhjen e tyre me strategjinë e njësisë; përkufizimet dhe metodologjinë; burimet e informacionit, supozimet dhe kufizimet; fushën e aktiviteteve në fjalë; standardet referencë; objektivat; tendencat; ndryshimet në metodologji (nëse ka); dhe shpjegimet cilësore të performancës së kaluar dhe asaj të pritshme.

3.3 Paraqitet informacion gjithëpërfshirës por konciz

Në nenin 18, pika të Ligjit të kontabilitetit përcaktohet që njësitë në fjalë:

'[...] Do të përfshijnë në raportin e ecurisë së veprimtarisë një raport jo-financiar që përmban informacion në masën e nevojshme për të kuptuar zhvillimin, performancën, pozicionin dhe ndikimin e veprimtarisë së njësisë, në lidhje me çështjet mjedisore, sociale, të punonjësve, të respektimit të të drejtave të njeriut, antikorrupsionit dhe ryshfetit [...]'

Minimalisht, duhet dhënë informacion material për kategori të caktuara të çështjeve që reflektohen qartë në këtë nen. Kjo përfshin:

- çështjet mjedisore, sociale dhe të punonjësve;
- respektimin e të drejtave të njeriut;
- çështjet anti-korrupsion dhe ryshfetet.

Njësiti gjithashtu duhet të paraqesin çdo informacion tjetër material

Shpjegimet për informacionin material pritet të japin një pamje të plotë të njësisë në vitin raportues. Kjo i referohet gjerësisë së informacionit të paraqitur. Sidoqoftë, thellësia e informacionit të raportuar për ndonjë çështje të veçantë varet nga materialiteti i tij. Një njësi duhet të përqendrohet në sigurimin e gjerësisë dhe thellësisë së informacionit që do t'i ndihmojë palët e interesuara të kuptojnë zhvillimin, performancën, pozicionin dhe ndikimin e aktiviteteve të saj.

Raporti jo-financiar gjithashtu pritet të jetë konciz, dhe të shmangë informacionin jomaterial. Paraqitja e informacionit jomaterial mund ta bëjë raportin jo-financiar më pak të kuptueshëm për faktin se minimizon peshën e informacionit material. Duhet të shmangen informacionet e përgjithshme ose ato që nuk janë materiale.

Raporti jo-financiar mund të përfshijë referenca të kryqëzuara të brendshme ose shenja orientuese për të qenë konciz, të kufizojë përsëritjen dhe të sigurojë lidhje me informacione të tjera.

Shembull

Një njësi mund ta përmbledhë informacionin, të përqendrohet në informacionin material, të heqë informacionin e përgjithshëm, të kufizojë detajet, të shmangë elementet që nuk janë të rëndësishëm, të përdorë referenca kryqëzuese dhe orientuese, etj.

3.4 Paraqet informacion strategjik dhe parashikues

Raporti pritet të ofrojë informacion mbi modelin e biznesit, strategjinë dhe zbatimin e saj dhe të shpjegojë implikimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të informacionit të raportuar.

Njësiti pritet të paraqesin informacionin përkatës për modelin e biznesit të tyre, përfshirë strategjinë dhe objektivat e tyre. Raporti jo-financiar ofron informacion mbi qasjen strategjike të çështjeve relevante jo-financiare; çfarë bën një njësi, si dhe pse e bën atë.

Duke dhënë informacion mbi objektivat, standardet më të mira dhe angazhimet, një njësi mund të ndihmojë investitorët dhe palët e tjera të interesuara për të lexuar performancën e njësisë brenda një konteksti të caktuar. Kjo mund të jetë e dobishme kur vlerësohet perspektiva në të ardhmen. Monitorimi i jashtëm i angazhimeve dhe përparimeve drejt objektivave promovon transparencë më të madhe ndaj palëve të interesuara. Synimet dhe standardet mund të paraqiten në terma cilësor ose sasior. Sipas rastit, njësiti mund të paraqesin informacion jo-financiar të rëndësishëm bazuar në skenarë shkencorë.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të shpjegojë se si aplikon një strategji të qëndrueshme biznesi dhe se si performanca mjedisore, sociale dhe e qeverisjes së brendshme mund të ndihmojë në arritjen e qëllimeve të saj të biznesit. Njësia gjithashtu mund të shpjegojë objektivat dhe synimet në lidhje me treguesit kryesorë të raportuar të performancës dhe të shpjegojë pasiguritë dhe faktorët që mund të mbështesin informacionin mbi ecurinë në të ardhmen dhe perspektivat e ardhshme.

Informacioni mbi të ardhmen u lejon përdoruesve të informacionit të vlerësojnë më mirë aftësinë dhe qëndrueshmërinë e zhvillimit, pozicionit, performancës dhe ndikimit të një njësie me kalimin e kohës. Ndhmon gjithashtu përdoruesit të matin progresin e njësisë drejt arritjes së objektivave afatgjatë.

Shembull

Një njësi mund të paraqesë informacion të rëndësishëm mbi strategjitë dhe aktivitetet e saj, bazuar në ndikimin e pritshëm të skenarëve shkencorë të ndryshimit të klimës. Në mënyrë alternative, mund të paraqesë objektivat për zvogëlimin e numrit të aksidenteve në punë ose sëmundjeve profesionale.

3.5 Paraqet informacion të orientuar nga palët e interesit

Njësitë pritet të marrin në konsideratë nevojat për informacion të të gjithë të interesuarve përkatës. Por, njësitë duhet të përqendrohen në nevojat për informacion të palëve të interesuara si një grup kolektiv dhe jo në nevojat ose preferencat individuale të aksion mbajtësve apo në kërkesa të paarsyeshme për informacion të të interesuarve atipikë.

Sipas rastit, grupet kolektive, mund të përfshijnë ndër të tjera: investitorët, punëtorët, konsumatorët, furnitorët, klientët, komunitetet lokale, autoritetet publike, grupet vunerabile, partnerët dhe shoqërinë civile.

Njësitë duhet të japin informacione të rëndësishme dhe të dobishme për angazhimin e tyre me palët e interesuara përkatëse, dhe se si merren parasysh nevojat e tyre për informacion.

Për shembull, ISO 26000 dhe Udhëzimet e OECD për kompanitë shumëkombëshe japin udhëzime të dobishme për këtë.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të paraqesë informacione materiale mbi angazhimin e saj me palët e interesuara dhe të shpjegojë se si kjo ndikon në vendimet, performancën dhe ndikimin e aktiviteteve të saj.

3.6 Paraqitet informacion i qëndrueshëm dhe koherent

Raporti jo-financiar pritet të jetë në përputhje me elementet e tjerë të raportit të ecurisë së veprimtarisë.

Lidhja e qartë midis informacionit të paraqitur në raportin jo-financiar dhe informacioneve të tjera të dhëna në raportin e ecurisë së veprimtarisë e bën informacionin më të dobishëm, të rëndësishëm dhe koheziv. Raporti i ecurisë së veprimtarisë duhet të shihet si një set i vetëm, i ekuilibruar dhe koherent i informacionit.

Përderisa përmbajtjet e raporteve janë të lidhura me njëra-tjetrën, shpjegimi i lidhjeve kryesore e bën më të lehtë për investitorët dhe palët e tjera të interesuara të kuptojnë informacionin material dhe ndërvarësinë.

Përmbajtja e raportit jo-financiar duhet të jetë konsistente përgjatë gjithë kohës. Kjo u mundëson përdoruesve të informacionit të kuptojnë dhe krahasojnë ndryshimet në zhvillimin, pozicionin, performancën dhe ndikimin e një njësie në të kaluarën dhe në të tashmen, krahasuar gjithashtu dhe me informacionin e besueshëm mbi të ardhmen.

Konsistenca në zgjedhjen dhe metodologjinë e treguesve kryesorë të performancës është e rëndësishme për të siguruar që raporti jofinanciar të jetë i qëndrueshëm dhe i besueshëm. Sidoqoftë, përditësimet mund të jenë të nevojshme, pasi treguesit kryesorë të performancës mund të vjetrohen, ose të zhvillohen metodologji të reja dhe më të mira që përmirësojnë cilësinë e informacionit. Njësitë pritet të shpjegojnë çdo ndryshim në politikën ose metodologjinë e raportimit, arsyet e ndryshimit të tyre dhe efektet e tyre (për shembull duke përsëritur informacionin e kaluar, duke treguar qartë efektin e ndryshimit të politikave ose metodologjive të raportimit).

Shembull

Një njësi mund të identifikojë marrëdhëniet dhe lidhjet midis modelit të saj të biznesit dhe aspekteve të korrupsionit dhe ryshfetit.

4. PËRMBAJTJA

Njësitë pritet të identifikojnë aspektet specifike tematike dhe informacionin material që do të përfshihet në raportin jo-financiar në mënyrë të drejtë, të ekuilibruar dhe gjithëpërfshirëse, përfshirë këtu edhe angazhimin me palët e interesuara.

Informacioni në raportin jo-financiar është i ndërlidhur. Për shembull, rezultatet pasqyrojnë jo vetëm atë që bën një njësi (dhënë kjo përmes modelit të saj të biznesit, politikave dhe strategjive), por edhe rrethanat dhe rreziqet specifike të njësisë, si dhe sa efektive është njësia në administrimin e atyre rreziqeve. Shpjegimi i lidhjeve kryesore dhe ndërvarësive përmirëson cilësinë e raportit.

Gjatë përgatitjes së raportit jo-financiar, njësitë duhet të kenë parasysh rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

4.1 Modeli i biznesit

Neni 18 (1) i ligjit të kontabilitetit, përcakton që raporti jo-financiar përmban informacione, ku përfshihet:

a. *'një përshkrim i shkurtër i modelit të biznesit të njësisë;'*

Modeli i biznesit të një njësie përshkruan se si njësia gjeneron dhe ruan vlerën përmes produkteve ose shërbimeve të saj në afat gjatë. Modeli i biznesit siguron kontekstin e raportit të ecurisë së veprimtarisë në tërësi. Ai siguron një përmbledhje të mënyrës se si funksionon një njësi dhe arsyetimin e strukturës së saj, duke përshkruar se si i shndërron inputet në outpute përmes aktiviteteve të biznesit. Në terma më të thjeshtë, çfarë bën një njësi, si dhe pse e bën atë.

Kur përshkruajnë modelin e tyre të biznesit, njësitë mund të konsiderojnë përfshirjen e informacioneve shpjeguese përkatëse në lidhje me:

- mjedisin e tyre të biznesit;
- organizimin dhe strukturën e tyre;
- tregjet ku veprojnë;
- objektivat dhe strategjitë e tyre;
- tendencat dhe faktorët kryesorë që mund të ndikojnë në zhvillimin e tyre në të ardhmen.

Njësitë mund të përdorin treguesit kryesorë të performancës për të shpjeguar modelin e tyre të biznesit, tendencat kryesore, etj.

Njësitë pritet të shpjegojnë modelin e tyre të biznesit në një mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe të bazuar në fakte. Një model biznesi është një fakt ekzistues. Njësitë duhet të shmangin dhënien e informacioneve jomateriale të natyrës promovuese ose aspiruese të cilat largojnë vëmendjen nga informacioni material.

Njësitë pritet të nxjerrin në pah dhe të shpjegojnë në vitin raportues, kur kanë ndodhur ndryshimet materiale në modelin e tyre të biznesit.

Shembull

Një njësi mund të marrë në konsideratë dhënien e informacioneve specifike kur shpjegon:

- produktet kryesore që ajo bën, dhe se si ato plotësojnë nevojat e konsumatorëve;
- si bëhen këto produkte dhe çfarë e bën prodhimin e saj konkurrues dhe të qëndrueshëm;
- karakteristikat e tregut ku operon dhe si mund të zhvillohet ky treg;

4.2 Politikat dhe due diligence

Neni 18 (1) i ligjit të kontabilitetit thotë se raporti jo-financiar përmban informacione, përfshirë:

b. *'një përshkrim të politikave të ndjekura nga njësia në lidhje me ato çështje, përfshirë zbatimin e procesit due diligence;'*

Njësitë duhet të paraqesin informacione materiale që ofrojnë një pamje të drejtë të politikave të tyre. Ato duhet të marrin në konsideratë dhënien e informacionit për aspektet kryesore jofinanciare, objektivat kryesore dhe mënyrën se si njësitë po planifikojnë të realizojnë objektivat e tyre si edhe mënyrën si po e zbatojnë këtë plan. Çdo informacion i dhënë do të marrë parasysh rrethanat specifike të njësisë. Në shënimet shpjeguese dhe në raportin jo-financiar, një njësi mund të shpjegojë përgjegjësitë dhe vendimet e Këshillit të Drejtimit dhe se si shpërndarja e burimeve lidhet me objektivat, menaxhimin e rreziqeve dhe rezultatet e synuara. Për shembull, një njësi mund të shpjegojë aspektet përkatëse të qeverisjes, përfshirë edhe Këshillin Mbikëqyrës.

Shembull

Një njësi mund të konsiderojë dhënien e informacionit në lidhje me organizatën e saj dhe strukturën e qeverisjes, se kush është përgjegjës për vendosjen, zbatimin dhe monitorimin e një politike specifike, për shembull, për çështje që lidhen me klimën. Njësia gjithashtu mund të përshkruajë rolin dhe përgjegjësinë e Këshillit të Drejtimit / Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me politikat mjedisore, sociale dhe të drejtat e njeriut.

Proceset *due diligence* kanë të bëjnë me politikat, menaxhimin e rrezikut dhe rezultatet. Proceset *due diligence* ndërmerren nga një njësi për të siguruar që ajo po punon për një objektiv konkret (p.sh. për të siguruar që emetimet e karbonit të jenë nën një nivel të caktuar ose që zinxhirët e furnizimit të jenë të lirë nga trafikimi i qenieve njerëzore). Proceset *due diligence* ndihmojnë në identifikimin, parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve anësore negative, ekzistuese dhe të mundshme.

Njësitë duhet të japin informacione shpjeguese mbi proceset e *due diligence* të zbatuar, përfshirë, aty ku është e nevojshme dhe proporcionale, informacion mbi furnitorët e saj dhe zinxhirët nënkontraktues. Njësitë gjithashtu mund të konsiderojnë dhënien e informacionit për vendimet e marra për krjimin e tyre dhe se si proceset synojnë të funksionojnë, veçanërisht në lidhje me parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve anësore negative. Njësitë gjithashtu mund të konsiderojnë ofrimin e informacionit përkatës për përcaktimin e synimeve dhe matjen e progresit.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të japë informacione shpjeguese mbi politikat e saj që synojnë të shmangin përdorimin e kimikateve të rrezikshme, substancave me ngarkesë shumë të lartë ose bioksideve në produktet, operacionet dhe zinxhirin e furnizimit të saj. Njësia gjithashtu mund të shpjegojë politikat e veta për kërkimin, zhvillimin dhe përdorimin e alternativave të sigurta. Njësitë mund të shpjegojnë se si vlerësojnë cilësinë, sigurinë dhe ndikimin në mjedis të kimikateve që përdorin dhe se si ato plotësojnë kërkesat ligjore për sigurinë kimike.

Shembull

Një njësi mund të japë informacionin përkatës se si identifikon, vlerëson dhe administron rreziqet që lidhen me klimën dhe / ose kapitalin natyror.

Njësitë pritet të nxjerrin në pah dhe të shpjegojnë çdo ndryshim material në politikat e tyre kryesore dhe proceset *due diligence* gjatë vitit raportues.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të konsiderojë dhënien e informacioneve vijuese të shëndetit dhe sigurisë:

- politikat për sigurinë e vendit të punës;
- detyrimet kontraktuale të negociuara me furnitorët dhe nënkontraktuesit;
- burimet e alokuara për menaxhimin e rrezikut, sigurimin e informacionit, trajnimin e stafëve, monitorimin, auditimin, bashkëpunimin me autoritetet lokale dhe partnerët socialë.

Mund të ndodhë që një njësi të mos ketë hartuar politika për çështje të caktuara, të cilat vazhdon t'i konsiderojë materiale. Kjo njësi duhet të japë një shpjegim të qartë dhe të arsyeshëm për mos hartimin e këtyre politikave. Kërkesat e tjera për raportimin jo-financiar vijojnë të zbatohen (për shembull, modeli i biznesit, rreziqet kryesore ...).

Neni 18 (2) i Ligjit të kontabilitetit thotë se "kur njësia nuk ndjek politika në lidhje me një ose disa nga çështjet e parashikuara në pikën 1 të po këtij neni, raporti jo-financiar duhet të japë një shpjegim të qartë dhe të arsyeshëm se përse është vepruar kështu."

4.3 Rezultati

Neni 18 (1) i ligjit të kontabilitetit përcakton që raporti jo-financiar duhet të përmbajë informacione, përfshirë:

c. "përfitimet e këtyre politikave;"

Njësitë duhet të japin një pamje të dobishme, të drejtë dhe të ekuilibruar të përfitimeve të politikave të tyre.

Informacioni jo-financiar i paraqitur nga njësitë duhet të ndihmojë investitorët dhe palët e tjera të interesuara të kuptojnë dhe monitorojnë performancën e njësisë.

Dhënia e informacioneve përkatëse në lidhje me përfitimet e politikave mund të ofrojë informacion të dobishëm për pikat e forta dhe të dobëta të njësisë. Raporti jo-financiar duhet të pasqyrojë në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe koncize rezultatet e operacioneve dhe veprimtarive të një njësie.

Njësitë mund të marrin në konsideratë shpjegimin e marrëdhënies midis rezultateve financiare dhe jofinanciare dhe se si menaxhohet kjo në kohë.

Analiza e rezultateve duhet të përfshijë treguesit kryesorë të performancës jo-financiare. Njësitë pritet të japin informacion për treguesit kryesorë të performancës që ata i konsiderojnë më të dobishëm në monitorimin dhe vlerësimin e progresit dhe mbështetjen e krahasueshmërisë midis njësisë dhe sektorëve. Kur është e përshtatshme, njësitë gjithashtu mund të marrin në konsideratë prezantimin dhe shpjegimin e këtij informacioni në lidhje me synimet dhe standardet më të mira për t'u ndjekur.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të konsiderojë përfshirjen e informacioneve shpjeguese specifike që shpjegojnë:

- emetimet aktuale të karbonit, intensitetin e karbonit;
- përdorimin e kimikateve të rrezikshëm ose bioksidëve;
- ndikimet (mbi) dhe varësitë (nga) kapitali natyror;
- krahasimi i rezultateve përkundrejt synimeve, zhvillimet në kohë;
- shmangia e efekteve anësore të politikave të zbatuara;
- planifikimi për zvogëlimin e emetimeve të karbonit.

4.4 Rreziqet kryesore dhe menaxhimi i tyre

Në nenin 18 (1) të ligjit të kontabilitetit thuhet se raporti jo-financiar duhet të përmbajë informacione, përfshirë:

- d. *'riskun kryesor lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetin e shfrytëzimit të njësisë ekonomike, duke përfshirë, kur është e nevojshme, lidhjet e biznesit, produktet ose shërbimet, të cilat kanë të ngjarë të shkaktojnë ndikim të ndërsjellë dhe se si njësia ekonomike e menaxhon riskun e tyre;'*

Njësitë duhet të paraqesin informacione mbi rreziqet kryesore dhe mënyrën se si ato menaxhohen dhe shmangen. Këto rreziqe mund të lidhen me aktivitetet, produktet ose shërbimet e tyre, zinxhirin e furnizimit dhe marrëdhëniet e biznesit, ose me aspekte të tjera. Mund të përfshihet në raport një perspektivë për rreziqet kryesore, të mesme dhe afatgjata. Njësitë pritet të shpjegojnë se si rreziqet kryesore mund të ndikojnë në modelin e biznesit të tyre, operacionet, performancën financiare dhe ndikimin e aktiviteteve të tyre.

Një njësi pritet të paraqesë informacione materiale mbi rreziqet kryesore, pavarësisht nëse ato burojnë nga vendimet ose veprimet e veta, ose nga faktorët e jashtëm. Njësia duhet të shpjegojë proceset e përdorura për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqe të tilla.

Dhënia e informacioneve shpjeguese, aty ku është e rëndësishme dhe proporcionale, duhet të përfshijë informacion material mbi zinxhirët e furnizimit dhe nënkontraktimit. Shënimet gjithashtu duhet të përfshijnë informacione materiale se si një njësi administron dhe shmang rreziqet kryesore.

Një njësi pritet të nxjerrë në pah dhe të shpjegojë çdo ndryshim material në rreziqet e saj kryesore, ose në mënyrën si i administron ato në vitin raportues.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të konsiderojë përfshirjen e informacioneve shpjeguese specifike për:

- mosfunksionimin e produkteve me efekte të mundshme në sigurinë e konsumatorëve;
- politikat e zbatuara për të adresuar çështjen;
- masat përmirësuese që adresojnë nevojat e konsumatorëve të cënuar tashmë nga këto produkte.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të konsiderojë dhënien e informacionit material mbi ndikimet mbi klimën e veprimtarisë dhe strategjisë së saj, duke marrë parasysh rrethanat e saj specifike dhe duke përfshirë vlerësimet e duhura për mundësinë e ndodhjes dhe përdorimit të analizave të skenarëve të mundshëm.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të konsiderojë dhënien e informacioneve materiale mbi rreziqet e çenimit të të drejtave të njeriut, të punës dhe mbrojtjes së mjedisit, në zinxhirin e saj të furnizimit dhe nënkontraktimit dhe se si njësi administrojnë dhe zbut ndikimet e mundshme negative.

4.5 Treguesit kryesorë të performancës (TKP-të)

Në nenin 18 (1) të ligjit të kontabilitetit thuhet se raporti jo-financiar duhet të përmbajë informacione, përfshirë:

e. 'treguesit kryesorë të performancës jo-financiare në lidhje me biznese të veçanta;'

Raporti jo-financiar duhet të përfshijë informacione shpjeguese, përshkruese dhe të lidhura me treguesit kryesorë të performancës.

Njësitë pritë të raportojnë ata tregues të performancës jofinanciare që janë të dobishëm duke marrë parasysh rrethanat e tyre specifike. TKP-të duhet të jenë në përputhje me metodat e përdorura nga njësi në menaxhimin e brendshëm dhe proceset e vlerësimit të rrezikut. Kjo i bën informacionet në raport më të rëndësishme dhe më të dobishme si dhe përmirëson transparencën. Shpjegimi i TKP-ve të një cilësie të lartë, gjerësisht të njohura (për shembull, metoda të përdorura gjerësisht në një sektor ose për çështje specifike tematike) gjithashtu mund të përmirësojnë krahasueshmërinë, veçanërisht për njësitë brenda të njëjtit sektor ose zinxhir vlere.

Një njësi duhet të shpjegojë TKP-të që janë të nevojshme për të kuptuar zhvillimin, performancën, pozicionin dhe ndikimin e veprimtarisë së saj. Disa TKP mund të jenë të dobishëm për një gamë të gjerë njësisish dhe rrethanash biznesi. TKP-të e tjera lidhen më shumë me çështjet dhe rrethanat e një sektori të caktuar. Njësitë inkurajohen të shpjegojnë TKP-të materiale, të përgjithshme dhe sektoriale. Duke marrë parasysh rrethanat e tyre specifike dhe nevojat për informacion të investitorëve apo të interesuarve të tjerë, njësitë pritë të ofrojnë një pamje të drejtë dhe të ekuilibruar duke përdorur TKP të përgjithshme, sektoriale dhe specifike për njësinë.

Përdoruesit e informacionit kanë tendencë ta vlerësojnë shumë informacionin sasior pasi i ndihmon ata të matin progresin, të kontrollojnë qëndrueshmërinë në kohë dhe të bëjnë krahasime. Shpjegimet e përshtatshme të TKP-ve ndihmojnë që raporti jo-financiar të bëhet më i kuptueshëm.

TKP-të konsiderohen gjithashtu mjete efektive për të lidhur informacion cilësor dhe sasior dhe për të krijuar lidhje të brendshme të raportit. Ato mundësojnë që njësitë të ofrojnë një pamje të ekuilibruar dhe gjithëpërfshirëse në mënyrë koncize dhe efektive.

TKP-të duhet të përdoren në mënyrë të qëndrueshme, nga një periudhë raportimi në tjetrën, në mënyrë që të sigurojnë informacion të besueshëm mbi progresin dhe tendencat. TKP-të e raportuara, natyrisht, mund të evoluojnë me kalimin e kohës për arsye biznesi ose teknike. Në këto raste, njësitë duhet të shpjegojnë arsyet pse TKP-të ndryshuan. Njësitë mund të konsiderojnë rikthimin e informacioneve të së kaluarës, kur është e përshtatshme dhe të shpjegojnë qartë dhe në mënyrë efektive, efektin e këtyre ndryshimeve.

Njësitë mund të shpjegojnë mbledhjen e të dhënave, metodologjinë dhe kuadrin ku janë mbështetur. Ato gjithashtu mund të ofrojnë një analizë të TKP-ve të paraqitura, duke shpjeguar për shembull pse TKP-të u shtuan apo pakësuan në vitin raportues dhe se si TKP-të mund të evoluojnë në të ardhmen.

Njësitë mund të paraqesin TKP-të në kontekstin e objektivave, performancës së kaluar dhe krahasimit me njësi të tjera, sipas rastit.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të marrë parasysh shpjegimet e duhura për metodat dhe objektivat e përdorura, për të vlerësuar dhe menaxhuar çështjet përkatëse të mjedisit dhe klimës.

4.6 Aspektet tematike

Neni 18 (1) i Ligjit të kontabilitetit thotë se njësitë në fjalë ‘përfshijnë në raportin e ecursisë së veprimtarisë një raport jofinanciar, i cili përmban informacionin e nevojshëm për një kuptim më të mirë të zhvillimit të vetë njësisë ekonomike, performancës, pozicionit dhe ndikimit e aktivitetit të saj lidhur me mjedisin, çështjet sociale dhe ato të punësimit, respektimin e të drejtave të njeriut, antikorrupsionin dhe çështje të ryshfetit [...]’.

Dhënia e informacioneve shpjeguese materiale duhet të sigurojë një pamje të ekuilibruar dhe gjithëpërfshirëse të zhvillimit, performancës, pozicionit dhe ndikimit të veprimtarisë së një njësie.

Në rrethana të caktuara, njësitë mund të konsiderojnë se dhënia e informacioneve të hollësishme, në lidhje me zhvillimet (çështjet) në pritje apo në fazë negociatash, do të ishte me paragjykime serioze. Sidoqoftë, dhënia e një informacioni të përmbledhur pa paragjykime serioze mund të çojë gjithësesi drejt përmbushjes së objektivit të përgjithshëm të transparencës.

Aspektet tematike shpesh janë të ndërlidhura. Për shembull, një çështje mjedisore që lidhet me aktivitetet, prodhimet ose zinxhirin e furnizimit të një njësie gjithashtu mund të ketë një ndikim në sigurinë dhe / ose shëndetin e konsumatorëve, punonjësve, furnitorëve ose në reputacionin e markës. Njësitë pritet të japin një pamje të qartë, të drejtë dhe gjithëpërfshirëse që përfshin të gjitha aspektet e rëndësishme të një çështjeje.

Çështjet e mëposhtme përbëjnë një listë jo-shteruese të aspekteve tematike që njësitë pritet të marrin parasysh kur japin informacione jo-financiare:

a. Çështjet mjedisore

Një njësi pritet të japë informacion të rëndësishëm mbi ndikimet aktuale dhe të mundshme të aktiviteteve të saj në mjedis, dhe se si çështjet aktuale dhe të parashikueshme mjedisore mund të ndikojnë në zhvillimin e njësisë, performancën ose pozicionin.

Kjo mund të përfshijë:

- shënime shpjeguese materiale për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes;
- ndikimin mjedisor nga përdorimi i energjisë;
- emetimet direkte dhe indirekte atmosferike;
- përdorimin dhe mbrojtjen e burimeve natyrore (p.sh. uji, toka) dhe mbrojtjen e biodiversitetit;
- menaxhimin e mbeturinave;
- ndikimet mjedisore nga transporti ose nga përdorimi dhe asgjësimi i produkteve dhe shërbimeve; dhe
- zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të gjelbra.

Njësitë mund t'i referohen, kur është e përshtatshme, informacionit material të dhënë në kontekstin e kërkesave specifike të raportimit mjedisor.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të konsiderojë tregues të tillë si:

- performanca e energjisë dhe përmirësimet në performancën e energjisë;
- konsumi i energjisë nga burimet jo të rinovueshme dhe intensiteti i energjisë;
- emetimet e gazrave serë, matur në ton, të ekuivalentit të CO₂ dhe intensiteti i gazit serë;
- emetimet e ndotësve të tjerë (matur në vlerë absolute dhe në intensitet);
- shfrytëzimi i burimeve natyrore;
- ndikimet dhe varësitë nga kapitali natyror dhe biodiversiteti;
- menaxhimi i mbetjeve (p.sh. nivelet e riciklimit).

b. Çështjet sociale dhe të punonjësve

Njësitë pritet të japin informacione materiale mbi çështjet sociale dhe ato të punonjësve. Këtu përfshihet:

- zbatimi i legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës;
- çështjet e diversitetit, siç janë diversiteti gjinor dhe trajtimi i barabartë në punësim dhe profesion (përfshirë moshën, gjininë, orientimin seksual, fenë, aftësinë e kufizuar, origjinin etnike dhe aspektet e tjera të rëndësishme);
- çështjet e punësimit, përfshirë konsultimin e punonjësve dhe / ose pjesëmarrjen, punësimin dhe kushtet e punës;
- marrëdhëniet sindikale, përfshirë respektimin e të drejtave të sindikatave;

- menaxhimi i kapitalit njerëzor përfshirë menaxhimin e ristrukturimit, menaxhimin e karrierës dhe punësimin, sistemin e shpërblimit, trajnimet;
- shëndeti dhe siguria në punë;
- marrëdhëniet me konsumatorin, përfshirë kënaqësinë e konsumatorit, aksesueshmërinë, produktet me efekte të mundshme në shëndetin dhe sigurinë e tyre;
- ndikimet tek konsumatorët vunerabël;
- marketingu dhe hulumtimi i përgjegjshëm; dhe
- marrëdhëniet brenda komunitetit, përfshirë zhvillimin social dhe ekonomik të komuniteteve lokale.

Njësitë mund ta shohin të dobishme të mbështeten në kuadro gjerësisht të njohura dhe me cilësi të lartë, për shembull Udhëzimet e OECD për njësitë shumëkombëshe, Deklarata Trepalëshe e Parimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me njësitë shumëkombëshe dhe politikën sociale, ose ISO 26000.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të marrë në konsideratë paraqitjen e TKP-ve bazuar në aspekte të tilla si:

- diversiteti gjinor dhe aspektet e tjera të diversitetit;
- punonjësit që kanë të drejtë për leje prindërore, sipas gjinisë;
- punëtorët që marrin pjesë në aktivitete me një rrezik të lartë të aksidenteve ose sëmundje specifike;
- numri i aksidenteve në punë, llojet e dëmtimeve ose sëmundjeve profesionale;
- qarkullimi i punonjësve;
- raporti i punonjësve që punojnë me kontrata të përkohshme, sipas gjinisë;
- orët mesatare të trajnimit në vit për çdo punonjës, sipas gjinisë;
- proceset e konsultimit të punonjësve;
- numri i personave me aftësi të kufizuara të punësuar.

c. Respektimi i të drejtave të njeriut

Njësitë pritet të japin informacione materiale mbi ndikimet e mundshme dhe aktuale të operacioneve të tyre tek mbajtësit e të drejtave.

Konsiderohet si ‘praktika më e mirë’ që një njësi të shprehë përkushtimin e saj për respektimin e të drejtave të njeriut. Ky angazhim mund të përcaktojë atë që njësi pret nga menaxhimi, punonjësit dhe partnerët e saj të biznesit në lidhje me të drejtat e njeriut, përfshirë standardet themelore të punës. Informacioni mund të shpjegojë të drejtat e kujt angazhimi adreson, për shembull të drejtat e fëmijëve, grave, pakicave kombëtare, personave me aftësi të kufizuara, komunitetet lokale, fermerët e vegjël, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të drejtat e punëtorëve, përfshirë ata që punojnë me kontrata të përkohshme, punëtorët në zinxhirët e furnizimit ose nënkontraktorët, punëtorët migrantë dhe familjet e tyre.

Njësitë duhet të marrin në konsideratë dhënien e informacioneve shpjeguese materiale mbi procesin *due diligence* për të drejtat e njeriut dhe proceset apo marrëveshjet e zbatuara për të

parandaluar abuzimet e të drejtave të njeriut. Kjo mund të përfshijë, për shembull, se si kontratat e një njësie me bizneset në zinxhirin e saj të furnizimit trajtojnë çështjet e të drejtave të njeriut dhe se si një njësi eliminon ndikimet e mundshme negative në të drejtat e njeriut dhe siguron ndreqjen e përshtatshme nëse në ndonjë rast të drejtat e njeriut janë shkelur.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të konsiderojë dhënien e informacionit material dhe TKP-ve për:

- shfaqjen e ndikimeve negative në të drejtat e njeriut në lidhje me aktivitetet ose vendimet e tij;
- procesin për pranimin dhe adresimin e ankesave si dhe sigurimin e mjeteve juridike kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut;
- aktivitetet dhe furnitorët me rrezik të konsiderueshëm të shkeljeve të të drejtave të njeriut;
- proceset dhe masat për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore për të gjitha format e shfrytëzimit, punën e detyruar ose të detyrueshme dhe punën e fëmijëve, punën e pasigurt dhe kushtet e pasigurta të punës, veçanërisht në lidhje me zonat gjeografike me rrezik më të lartë të ekspozimit ndaj abuzimit;
- mundësinë e aksesit në objektet, pajisjet, dokumentet dhe faqet e internetit të njësisë për personat me aftësi të kufizuara;
- respektimin e lirisë së grupimit në shoqata;
- angazhimet me palët e interesuara.

d. Çështjet e anti-korrupsionit dhe ryshfetit

Njësitë pritet të japin informacione materiale se si ata menaxhojnë çështjet dhe dukuritë e korrupsionit dhe ryshfetit.

Njësitë mund të marrin në konsideratë dhënien e informacioneve shpjeguese për mënyrën e organizimit, vendimmarrjes dhe menaxhimit si dhe burimet e alokuara për të luftuar korrupsionin dhe ryshfetin.

Njësitë gjithashtu mund të konsiderojnë shpjegimin se si ata vlerësojnë luftimin e korrupsionit dhe ryshfetit, si ndërmarrin veprime për të parandaluar ose zbutur ndikimet e pafavorshme, si monitorojnë efektivitetin dhe si komunikojnë mbi këtë çështje brenda dhe jashtë njësisë.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të marrë në konsideratë dhënien e informacionit material dhe TKP-të në lidhje me aspekte të tilla si:

- politikat, procedurat dhe standardet kundër korrupsionit;
- kriteret e përdorura në vlerësimet e rrezikut të lidhura me korrupsionin;
- proceset e kontrollit të brendshëm dhe burimet e alokuara për parandalimin e korrupsionit dhe ryshfetit;
- punonjësit që kanë marrë trajnime të përshtatshme;
- përdorimi i mekanizmave të “spiunit”;
- numri i veprimeve ligjore në pritje ose të përfunduara mbi sjelljen e konkurrencës së pandershme.

e. Të tjera

Zinxhirët e furnizimit

Njësitë, aty ku është e rëndësishme dhe proporcionale, pritet të japin informacione materiale mbi çështjet e zinxhirit të furnizimit që kanë implikime të rëndësishme për zhvillimin, performancën, pozicionin ose ndikimin e tyre. Kjo do të përfshinte informacionin e nevojshëm për një kuptim të përgjithshëm të zinxhirit të furnizimit të një njësie dhe mënyrën se si çështjet relevante jo-financiare merren në konsideratë në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit.

Nëse një njësi konsideron se dhënia e informacioneve të hollësishme në lidhje me zhvillimet (çështjet) në pritje apo në fazë negociatash, do të ishte seriozisht paragjyquese, ajo mund të përmbushë objektivin e përgjithshëm të transparencës duke dhënë informacione të përmbledhura që nuk janë me paragjykime serioze.

Shembull dhe treguesit kryesorë të performancës

Një njësi mund të marrë në konsideratë dhënien e informacionit material dhe TKP-të në lidhje me aspekte të tilla si monitorimi i furnizuesve në:

- praktikat e punës, përfshirë punën e fëmijëve dhe punën e detyruar, punën e pasigurt, pagat, kushtet e pasigurta të punës (përfshirë sigurinë në ndërtesë, pajisjet mbrojtëse, shëndetin e punëtorëve);
- trafikimin e qenieve njerëzore dhe çështje të tjera të të drejtave të njeriut;
- emetimet e gazrave serë dhe llojet e tjera të ndotjes së ujit dhe mjedisit;
- shpyllëzimin dhe rreziqet e tjera që lidhen me biodiversitetin; dhe
- monitorimin e ndikimit të njësisë tek furnitorët, për shembull, kushtet e saj të pagesës dhe periudhat mesatare të pagesës.

Mineralet në zonat e konfliktit

Njësitë, kur është e rëndësishme dhe proporcionale, pritet të japin informacione të rëndësishme në lidhje me procesin *due diligence* për të siguruar zinxhirë të përgjegjshëm furnizimi për kallajin, tantalin, tungstenin dhe arin nga zonat e prekura nga konflikti dhe me rrezik të lartë.

Njësitë pritet të japin informacione të rëndësishme në lidhje me performancën e politikave dhe praktikave *due diligence*, si dhe rezultatet e tyre, në lidhje me furnizimin me minerale nga zonat e konfliktit. Ata gjithashtu duhet të tregojnë hapat e ndërmarrë për të zbatuar ‘kuadrin pesë-hapësh’³ në qasjen *due diligence* të bazuar në rrezik, në zinxhirin e furnizimit me minerale siç përcaktohet në Udhëzimin Due Diligence të OECD, duke marrë parasysh pozicionin e tyre në zinxhirin e furnizimit.

³ OECD (2016), OECD Due Diligence Guidance for Responsible Supply Chains of Minerals from Conflict-Affected and High-Risk Areas: Third Edition, OECD Publishing, Paris. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264252479-en>

Njësitë pritet të paraqesin TKP-të në lidhje me natyrën dhe numrin e rreziqeve të identifikuara, masat e marra për të parandaluar dhe zbutur këto rreziqe; dhe mënyrën se si njësitë ka forcuar përpjekjet e saj në procesin *due diligence* me kalimin e kohës.

Treguesit specifik të performancës

Këta përfshijnë:

- proporcionin e furnizuesve të drejtpërdrejtë të rëndësishëm që kanë miratuar dhe zbatuar një politikë të *due diligence* për furnizimin me minerale nga zonat në konflikt, në përputhje me Udhëzimin për Due Diligence të OECD-së;
- shfrytëzimin e përgjegjshëm proporcional të kallajit, tantalit, tungstenit ose arit me origjinë nga zonat e prekura nga konflikti dhe me rrezik të lartë; dhe
- përqindjen e klientëve të rëndësishëm që kontraktualisht kërkojnë informacion për procesin *due diligence* për mineralet nga zonat e konfliktit, sipas udhëzimit për *due diligence* të OECD.

5. INFORMACIONE PËR DIVERSITETIN E KËSHILLIT TË DREJTIMIT

Ky seksion ofron udhëzime specifike që synojnë të ndihmojnë njësitë e mëdha të listuara të përgatisin përshkrimin e politikës së diversitetit të Këshillit të tyre të Drejtimit, i cili do të përfshihet në raportin e drejtimit të brendshëm⁴. Përshkrimi i politikës së diversitetit të Këshillit të Drejtimit nuk bën pjesë në raportin jo-financiar. Prandaj, kjo pjesë e udhëzimeve nuk parashikon nevojën për të dhënë informacione materiale mbi diversitetin si pjesë e raportit jo-financiar.

Neni 19 i Ligjit të kontabilitetit kërkon që njësitë e mëdha me interes publik të paraqesin në raportin e drejtimit të brendshëm:

‘një përshkrim të politikave të ndryshme të zbatuara lidhur me organet ekzekutive drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike për aspekte të tilla, si: moshë, gjinia apo prejardhja arsimore dhe profesionale, objektivat e këtyre politikave të ndryshme, si janë zbatuar dhe rezultatet për periudhën raportuese’

‘kur njësitë ekonomike nuk vepron sipas rregullave/kodit të drejtimit të brendshëm të shoqërisë, ajo duhet të japë një shpjegim se cilat janë pjesët e kodit të drejtimit të brendshëm, të cilat nuk i zbaton dhe arsyet për këto shmangie;

‘kur njësitë ekonomike ka vendosur të mos bëjë lidhjen me dispozitat e një kodi të caktuar të drejtimit të brendshëm, ajo shpjegon arsyet për këtë’.

Aspektet e diversitetit

Përshkrimi i politikës së diversitetit duhet të specifikojë cilat kritere të diversitetit janë aplikuar dhe të shpjegojë arsyet e zgjedhjes së tyre. Gjatë zgjedhjes së këtyre kritereve, të gjitha aspektet përkatëse të diversitetit duhet të merren parasysh për të siguruar që Këshilli i Drejtimit ka një diversitet të mjaftueshëm të pikëpamjeve dhe ekspertizën e nevojshme për një kuptim të mirë të

⁴ Neni 19 i Ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

çështjeve aktuale dhe rreziqeve si dhe mundësive afatgjata që lidhen me biznesin e njësisë. Kur vlerësohen profilet e nevojshme për diversitetin optimal të Këshillit të Drejtimit, duhet të merren parasysh natyra dhe kompleksiteti i biznesit të njësisë sikurse edhe konteksti shoqëror dhe mjedisor në të cilin operon njësia.

Aspektet e diversitetit duhet në përgjithësi të mbulojnë moshën, gjininë, ose prejardhjen arsimore dhe profesionale. Kur është e rëndësishme, për shkak të vendndodhjes gjeografike të njësisë dhe sektorit të biznesit në të cilin operon, është gjithashtu e përshtatshme që të përfshihet edhe përparësia gjeografike, përvoja ndërkombëtare, ekspertiza në çështjet përkatëse të qëndrueshmërisë, përfaqësimi i punonjësve dhe aspekte të tjera, për shembull sfondi socio-ekonomik.

Në zgjedhjen e një kandidati për anëtar në Bord në bazë të kriterëve të përcaktuara të diversitetit, duhet të merren parasysh rregullat dhe parimet përgjithësisht të pranuar të mosdiskriminimit.

Objektivat

Njësitë duhet të përshkruajnë objektiva specifike dhe të matshëm për aspektet përkatëse të diversitetit. Është sidomos e dobishme të vendosen objektiva sasiorë dhe afate kohore, veçanërisht në lidhje me balancën gjinore.

Zbatimi dhe rezultatet

Njësitë duhet të tregojnë se si objektivat e politikës së tyre të diversitetit merren parasysh në planifikimin, zgjedhjen, emërimin dhe vlerësimin e radhës. Njësitë gjithashtu duhet të tregojnë rolin e komiteteve kompetente të Këshillit Drejtues në këto procese. Njësitë gjithashtu duhet të tregojnë nëse informacioni rreth kriterëve dhe objektivave të diversitetit i'u është vënë në dispozicion aksionarëve kur ata zgjedhin ose rinovojnë anëtarët e Këshillit Drejtues, kur kjo është e nevojshme.

Njësitë duhet të tregojnë statusin e zbatimit të politikës së tyre të diversitetit dhe rezultatet e zbatimit të saj, të paktën që nga raportimi i fundit, për të gjitha aspektet e politikës së diversitetit. Nëse nuk përmbushen objektivat e diversitetit, njësia duhet të tregojë se si synon t'i përmbushë ato, përfshirë afatin kohor të pritshëm, brenda të cilit duhet të përmbushen këto objektiva.